



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI PERSONELIT

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të ligjit nr. 8224 datë 15.05.1997 ndryshuar me ligjin 8335 datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës”, VKM nr.313 datë 01.07.2002 “ Për caktimin e strukturës së numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë dhe Komunës “ i ndryshuar, ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , VKB nr. 158 datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022”, Bashkia Durrës shpall konkurimin për vende të lira pune në pozicionin :

• **Polic pranë Policisë Bashkiake (2 vende për Policë)**

Kërkesa të vecanta për kandidatët :

- Të ketë arsim të mesëm ose të lartë
- Të jetë në mosheë 19 – 27 vjeç
- Të ketë të paktën 3 vjet eksperience pune
- Të ketë aftësi të punës në grup, aftësi gjyquese dhe të kontrolloj situata të krijuara të paparashikuara.
- Të ketë aftësi të mira fizike dhe gjatësi trupore 1.75 cm
- Të ketë njohuri mbi programet bazë të kompjuterit.
- Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit

Pershkrimi specifik i punes per pozicionin Polic prane **Sektorit te Policise Bashkiake** : Te zbatoje Urdherat e nxjerra nga Kryetari i Bashkise dhe Keshilli Bashkiak, te kontrolloje ne zona te caktuara nga Bashkia dhe te beje konstatimin e parandalimin e shkeljeve administrative duke vepruar konform ligjit, te marre masa per ruajtjen e pasurise se Bashkise si dhe atyre qe administrohen prej saj, te marre masa per ruajtjen e rendit kur ka grumbullime njerezish, te inspektojte tregjet, te kontrolloje zenien e vendeve per tregti ambulante.

Literatura : Ligji nr. 8224 datë 15.05.1997 ndryshuar me ligjin 8335 datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës”, VKM nr.313 datë 01.07.2002 “ Për caktimin e strukturës së numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë dhe Komunës “ i ndryshuar,
Kandidati duhet të paraqes brenda datës 25.03.2022 në Drejtorine e Burimeve Njerëzore këto dokumenta :

1. Kërkesën për aplikim
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje të Dëftesës të noterizuar ose të diplomës
4. Fotokopje të librezës punës
5. Dëshmi kualifikimi për kompjuterin
6. Vlerësim pune nga punëdhënësi i mëparshëm
7. Fotokopje e kartës së identitetit.
8. Dëshmi e gjendjes gjyqësore.

Pas verifikimit paraprak më datë 31.03 .2022 në Bashki do të shpallet lista e aplikantëve që plotësojnë kushtet për testim.